



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.385/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatës për asamble komunale në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Gresa Latifi, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit pas rezultatit përfundimtar për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 05.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.385/2025, e datës 04.11.2025, e parashtruar nga Gresa Latifi, kandidate për asamble komunale në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit pas rezultatit përfundimtar për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 04.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatës për asamble komunale në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik LVV, Gresa Latifi, me të cilën pretendon se pas publikimit të rezultateve, ka vërejtur mospërputhje të dukshme ndërmjet numrit të votave që figurojnë në faqen zyrtare të KQZ-së dhe të dhënave që ka nga vëzhguesit e mi në terren. Këto mospërputhje më kanë shtyrë të dyshoj se mund të ketë pasur parregullësi në numërim ose manipulim të votave që më përkasin si kandidate. Në disa vendvotime specifike psh. SHFMU "Xhavit Ahmeti", SHFMU "Nazim Gafurri", SHFMU "Ahmet Gashi", SHFMU "Shkolla e Gjelbert", raportet që kam nga vëzhguesit tregojnë për një numër votash më të lartë sesa ai i publikuar nga KQZ. Për këtë arsye, kërkoj që PZAP të ndërmarrë veprimet e nevojshme për rishikimi dhe rinumërimin e votave në vendvotimet e përmendura më sipër, ose në të gjitha vendvotimet e Komunës së Prishtinës ku dyshohet për mospërputhje; hetimin e mundshëm të parregullsive që mund të kenë ndikuar në rezultatin tim personal si kandidate dhe sigurimin e transparencës së plotë në procesin e verifikimit dhe publikimit të rezultateve për të ruajtur integritetin e procesit zgjedhor.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 05.11.2025, ka deklaruar se bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/ L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të

korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, gjithashtu ju njofton se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr.14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, pala ankuese nuk ka afruar dëshmi lidhur me parregullsitë në numërimin e votave që i përkasin kandidateve për kuvendet komunale dhe me as një provë konkrete nuk ka mundur të konstatoj se ka pasur manipulim të votave, sa vota i mungojnë, në cilat vendvotime, cilat ekipe të numërimit në QKN dhe pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka pasur parregullsi dhe mungesë të votave. Pra, nuk ka bashkangjitur libër të votimit në vendvotim dhe QKN, formularë, ose prova të tjera që do të mund të mbështesnin pretendimet e saj.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se pretendimet e ankuses Gresa Latifi, janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara si në ankesë se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga vëzhguesit në teren, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e saj, kjo pasi që paraqitësja e ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në suaza të dyshimit, nga se nuk janë argumentuar me prova konkrete.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesë nuk ka ofruar dëshmi ose prove konkrete dhe kështu nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, qofte formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, apo librin e votimit, ose deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, në mbështetje të pohimeve të qytetarëve (votuesve), me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Rrjedhimisht duke marrë parasysh të lartcekurat, Paneli vlerësoi se parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.385/2025, datë 05.11.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.